

**I. Universiteti Politeknik i Tiranës, shpall 2 (dy) vende pune për personel ndihmësakademik pranë Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës si më poshtë:**

**A. 1 (një) vend pune për personel ndihmësakademik në pozicionin “Kryesekretare mësimore” në Fakultetin e Arkitekturës dhe Urbanistikës duhet të plotësojnë kriteret përcaktuese si më poshtë:**

1. Të ketë kryer arsimin e lartë dhe të ketë diplomë të nivelit të dytë, Master i Shkencave;
2. Të zotërojë me dëshmi universitare një gjuhë të huaj perëndimore, preferohet anglisht;
3. Të ketë njohuri të mira të programeve bazë kompjuterike;
4. Të ketë njohuri të mira komunikuese dhe kërkuese për realizimin e detyrave;
5. Të mos jetë larguar nga puna e mëparshme për masa disiplinore;
6. Të ketë eksperiencë punë në fusha të ngjashme.

**B. 1 (një) vend pune për personel ndihmësakademik në pozicionin “Laborant” në Departamentin e Urbanistikës, duhet të plotësojnë kriteret përcaktuese si më poshtë:**

1. Të ketë diplomë Master Shkencor të Integruar (ose ekuivalent me të) në fushat e Inxhinierisë dhe Arkitekturës. Preferohet të ketë kryer studime në fushën e Arkitekturës dhe Urbanistikës;
2. Të ketë eksperiencë pune mbi 5 (pesë) vite pune;
3. Preferohet të ketë eksperiencë pune administrative pranë institucioneve të ndryshme;
4. Preferohet të zotërojë me dëshmi/certifikatë një gjuhë të huaj, të vërtetuar me dëshminë përkatëse. Preferohet anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht.
5. Preferohet të ketë kryer kurse dhe kualifikime të mëtejshme, të cilat ndihmojnë në kontributin e tyre si laborantë pranë Departamentit.

## **II. DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT**

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Letër motivimi;
2. Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard;
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuara; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MAS);
5. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
6. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
7. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
8. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
9. Dëshminë e gjuhës së huaj e noterizuar.

Të gjithë kandidatët duhet të paraqesin brenda datës **30.11.2023** pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës, dokumentacionin e sipërcituar.